



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	229/22
Nr. i fq. / Br. sf.	- 20 -
Data / Datum	29. 09. 2022
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**PROCES VERBAL  
NGA MBLEDHJA E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 KORRIK 2022**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Faton Hyseni, Fatmire Cecelia, Galip Avdiu, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nurie Halili, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehollı, Spasoje Stefanoviq, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi:** Gresa Muli

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshmë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkyetari i komunës z. Shpëtim Zhegrovë, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** - lexoi para anëtarëve të kuvendit dispozitat e Rregullores të punës së kuvendit, lidhur me diskutimet, si dhe kërkoi që të respektohen këto dispozita ligjore ashtu që të jemi racionali në kohë në mbledhjen e kuvendit. Njëkohësisht ajo paraqiti para kuvendit pikat e rendit të ditës që janë dërguar si materiale në pikën në të ndryshime, për t'i inkorporuar në punimet e mbledhjes.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-adresoj kërkesën e banorëve të Bashkësisë Lokale të Stanofcit, duke kërkuar që kjo kërkesë për rregullimin e varrezave të dëshmorëve të viteve të 90-ta Sadri Maksuti dhe Sadik Mala të vrarë nga forcat serbe, të futet në rendin e ditës për aprovin e ndihmës

financiare nga komuna, në vlerë prej 3000 €. Kërkesa përkufizon ndihmë financiare për rregullimin e dy varreve dhe ngritjen e pllakës përkujtimore

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit** – pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se tash e më shumë se 7 muaj Komuna e Vushtrrisë qeveriset nga Ferit Idrizit dhe subjekti i tij politik PDK. Kryetari që zotohej që do ti përfundonte 55 projekte kapitale në 55 ditët e para të punës, nuk i realizoj ndonjërin nga to as pas më shumë se 230 ditëve (më shumë se 7 muaj) që kur mori detyrën.

Për më tepër, për 7 muaj nën Qeverisjen Idrizi, Çfarë kemi pare ? Më poshtë listoj disa nga dështimet apo keqpërdorimet siç ai deklaroj:

- 1.Vetëm 2.43 % të buxhetit për investime kapitale të realizuar, mbante qeverisja komunale më e dobët në nivel të komunave të Republikës, për sa i takon investimeve kapitale të cilat e rrisin zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien.
- 2.Reduktimet e tmerrshme të furnizimit me ujë e në ndër kohë për 7 muaj kryetari nuk ka arritur ta shtrij rrjetin e ujësjellësit te as një lokalitet i vetëm, ndonëse premtonte në fushën zgjedhore se për 6 muajt e parë e gjithë Vushtrri do të ketë ujë.
- 3.Për 7 muaj me Qeverisjen Idrizi, Vushtrria ka parë dorëheqjen e drejtorit të prokurimit pas 3 tenderëve të dhënë mbi bazat familjare dhe për njerëz me ndikim të partisë dhe në kundërshtim me ligjin që rregullon procedurat e prokurimit. Dorëheqjen e kemi parë por jo edhe distancimin e kryetarit nga kjo.
- 4.Në këta 7 muaj kemi parë konflikte interesit të raportuara nga Agjencinë Antikorrupsion për asamblistë dhe ish asamblistë të subjektit politik të kryetarit të përfshirë në projektin e Zonës Ekonomike në Lumadh nga të cilat veprime deri më sot asnjëherë nuk është distancuar kryetari Idrizi.
- 5.Për 7 muaj Qeverisje të Ferit Idrizit kemi parë politizimin e arsimt duke vendosur në komisione, njerëz të afërt me subjektin e vet politik përkundër argumenteve të opozitës. Pastaj për të nejtit anëtar ka konstatuar vet se kanë qenë të anshëm dhe fillimi i ka propozuar Kuvendit ti zavendesoj, pastaj e ka tërhequr edhe propozimin për ti zavendësuar.
- 6.Në këta 7 muaj kemi parë degradimin e skajshëm të shëndetësisë duke filluar nga zgjedhja e Drejtorit të QKMF-së pa kundër kandidat, caktimin në komisione të vlerësimit në konkurse të jashtme, shefin e grupit kuvendar të partisë së vet, e deri te kolapsimi i shërbimeve mjekësore me theks te veçantë i atyre laboratorike ku nga 21 parametra sa punoheshin në 2019 shërbimet kanë rënë në 3 parametra në fillim të vitit 2022, e deri në situatën e fundit të arrestimit të stafit që flet për gjendjen reale të degradimit të shëndetësisë së Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu për 7 muaj asgjë nuk ka lëvizur në drejtim të lëshimit të objektit të ri të QKMF-së.
- 7.Në 7 muaj Qeverisje të Ferit Idrizit kemi parë drejtoret dhe qeverisjen e ti që marrin mëditje zyrtare për vizita jashtë vendit edhe kur shkojnë deri në Kukës për homazhe te varri i “Hasan Prishtinës”.
- Çfarë nuk kemi parë ?
- 8.Në 7 muaj Qeverisje të Ferit Idrizit nuk kemi parë si Kuvend Komunal e as si qytetarë listën e rrugëve që do të asfaltohen, kubzohen apo rikonstruohen për këtë vit ndonëse kryetari ishte zotuar se do ti sillte në kuvend dhe do të ishte transparentë.
- 9.Në 7 muaj nuk kemi parë gatishmëri për debat të hapur në Kuvend sidomos për çështjet e furnizimit me ujë, çështjet e arsimt apo çështjet e shëndetësisë.

- 10.Nuk kemi parë për 7 muaj as një mjet bujqësor apo subvencion që ju ndahet bujqve apo fermerëve ndonëse kemi parë vizita tek ta, të cilat i vlerësojmë, por që normalisht se nuk mjaftojnë.
- Çfarë është përmirësuar në këto 7 muaj ?
- 11.Janë përmirësuar fotografitë zyrtare të qeverisjes dhe kryetarit pasi për këtë janë përkujdesur të blejnë me para publike një aparat fotografik në vlerën mbi 3000 mijë Euro.
- Çfarë ka ndryshuar vazhdimisht në këto 7 muaj ?
- 12.Në 7 muajt e parë të Qeverisjes Idrizi ka ndryshuar vazhdimisht lokacioni i tregut duke qenë sinonimi i ndryshimit për këtë periudhë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar parafolësit të tij për kritikat e adresuara për dështime në arsim, ceku se Drejtoria e Arsimit ka shënuar mjaft suksese si në nivel komunal ashtu edhe në atë nacional, duke cekuar organizmin e grave dhe duke motivuar nxënësit në aspektin pozitiv dhe ngritjen e performancës në mësimnxënje. Krahas kësaj Komuna e Vushtrrisë qëndron mirë në aspektin nacional sa i përket arsimit vendin e parë në nivel republikan SH.F.M.U “Liria Strofc” në sfidën e kodimit projekt monitorimi i fatkeqësive natyrore, ku garuan mbi 600 shkolla, vendi i dytë në nivel republikan Gjimnazi “Eqrem Çabej” me nxënësen Flutra Hyseni event i organizuar nga Presidenca e Kosovës. Pastaj vendin e parë SH.M.U.2 në disiplinën sportive fucall, vendi i parë në nivel republikan Gjimnazi “Eqrem Çabej” në Hendboll. Andaj duke ju referuar këtyre të arriturave shtoj se duhet pasur unitet dhe bashkëpunim për të pasur akoma më shumë suksese, e jo të kritikojmë vetë se për të bërë zhurmë politike dhe demagogji. Ai pyeti parafolësin e tij z.Meholli, se përse nuk e ngriti zërin në qeverisjen e kaluar kur ishin anuluar konkurse në shkollën “Nazmi Zhegrovë” dhe nuk proceduat material në prokurori për këto shkelje.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-fillimisht përgëzoi kryetarin e komunës për organizmin e aktiviteteve për nder të ditëve të diasporës të cilat tashmë janë bërë tradicionale. Më tej shtoi se ndoshta është normale që ndonjë aktivitet ndonjëherë edhe të dështoj, por nuk e kupton se si dështimet e aktiviteteve pretendohet të paraqiten si suksese, kjo përfaktin se më datën 22 korrik ka qenë i planifikuar një aktivitet-ballo me maska me stil të veshjes të viteve 1920-ta i njëjtë ka dështuar dhe në lidhje me këtë është heshtur dhe kjo është shumë e dëmshme, ndërsa në media ka dal se Drejtoria e Kulturës ka organizuar për herë të parë një aktivitet të tillë me ballo, ndërsa në praktikë nuk ka qenë asnjë njeri prezent. Ndërkaq me datë 23 korrik ka qenë e planifikuar të mbahet një tryezë me mërgimtar për turizëm malor urban dhe agro-turizëm dhe edhe ky aktivitet ka dështuar totalishtë ndërsa është prezantuar si sukses, për këtë pyeti se çfarë mendim kanë qeveria komunale a është dështim a sukses. Lidhur me monumentin Ura e Gurit, pyeti se cilët janë hapat që janë ndërmarr nga drejtoria dhe qeveria komunale, për mbrojtjen e ati monumenti, pasi që ai është duke u shkatërruar dhe parqet rrezik për qytetaret a është adresuar ky shqetësim në MKRS dhe organe tjera kompetente. Lidhur me disa OJQ që për të janë të panjohura e që në procesverbal janë të evidentuara ceku se nuk ka marrë përgjigje nga DKRS-ja, për të njëjtën kërkoj përgjigje me shkrim.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-lidhur me deklarimet e anëtarëve të kuvendit, theksoj se nga ta u lansuan disa të pavërteta siç është rasti me shpenzimin e buxhetit sa i përket investimeve kapitale me vetëm 2.23 % gjë e cila është e pasaktë dhe kjo mund të dokumentohet edhe nga zyrtarët kompetent të buxhetit. Andaj vlerësoi se nuk është mirë të keqpërdoret foltorja e kuvendit për të

shfaqur lajme të pasakta dhe të pavërteta. Mandej pretendimi i problemit me ujin e pijshëm është evident, por se nuk është se është gjendja alarmante siç thuhet, e për më tepër furnizimi me ujë nuk është në kompetencë direkt nga kryetari i komunës. Në këtë kontekst nuk është mirë të tentohet të krijohen kahje tjetër sepse nuk kanë munguar përpjekjet nga kryetari dhe qeveria komunale në bashkëpunim me kompaninë "Ujësjellësi", për ti mënjanuar pengesat dhe për të ofruar shërbim më të mirë sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm. Më tej shtoi se rritja e kapacitetit të ujit nuk do të paraqiste problem për ti përmembushur kërkasat përfundim ujë të pijshëm, por pa dashur të politizohet kjo çështje është pikërisht subjekti politike Lëvizja Vetëvendosje që ka bërë presion për uljen e kapacitetit të ujit në fabrikë e që kjo seriozisht parqet një fatkeqësi për komunën dhe qytetaret e Vushtrrisë. Kompania Ujësjellësi dihet se nuk menaxhohet nga komuna, por nga Qeveria e Kosovës, dhe kjo formë e presonit vërtet është e turpshme dhe për këtë qytetaret janë të vetëdijshëm. Pastaj u fol për dorëheqjen e Drejtorisë së Prokurimit, dhe edhe kjo nuk hyn në domenin e diskursit të interesit publik sepse dorëheqjet janë individuale dhe personale, dhe kësidoj është jo etike të tentohet që dikush të komprometohet përfundimisht ndonjë poen politik. Lidhur me politizimin e arsimit vlerësoi se kjo nuk është e vërtet dhe se kemi në krye një drejtoreshë që i gjithë qyteti e njehë dhe ka gjzon respekt dhe reputacion. Andaj sugjeroi që të ndaloj këto forma të shantazhit duke tentuar të krijohen imazhe të rrejshme në qytet. Degradimi i shëndetësie nuk është mirë të përmendet sepse anëtarë i kuvendit z.Meholli ka udhëhequr përfundimisht tri vjet dhe një pjesë të përgjegjësisë e mban ai vetë. Në fund lidhur me subvencionet në bujqësi vlerësoi se ka pasur parregullsi pikërisht nga LVV sa ka udhëhequr këtë dikaster dhe kjo duke i shtyrë qytetaret në participim dhe më vonë kanë ndodhur ngritja e çmimit të produkteve dhe kështu është vështirësuar ky proces i shpërndarje së tyre.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-tha se ai personalisht por edhe shumë brenda subjektit të tij politik, nuk kanë nevojë, për punësim familjare, për interesa personale, për tender apo gjëra të tillë, e ndërsa në qeverinë aktuale të komunë janë mbledhur perona të tillë që e rrëthojnë kryetarin e komunës. Kjo nuk është forma e duhur e qeverisjes pasi që perona e tillë posa ti realizojnë interesat e tyre do të kërkojnë realizimin e kërkuesave tjera.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-pasi i përshëndeti të pranishmit, në mënyrë të përbledhur u përgjigj në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit, ku ceku se propozimi i anëtarit të kuvendit z.Faton Hyseni për ndërtimin e pllakës përkujtimore të procedohet në rend të ditës, që të merret një vendim formal, sepse si kryetar i komunës ka të drejt të futet në marrëveshje përfundimisht projekte me bashkëfinancim. Pastaj shtoi se anëtarët e kuvendit z.Meholli dhe z.Maloku, po dëshirojnë të bëhen lider, por me gjuhën që janë duke përdorë si gjuhë e nxitjes nuk ndërtohet lidershipi. Mandej përfundimisht subjekteve politike që ju takojnë gjithë secili këta të fundit kanë nevojë akoma të profilizohen dhe ta marrin vetën. Vlerësoi se përgjigja e tij është përfundimisht respektuar kuvendaret dhe përfundimisht të opinionit të gjerë se gjërat e deklaruar nga këta anëtarë të kuvendit nuk janë të qëndrueshme. Në këtë kontekst duke ju drejtuar anëtarëve të kuvendit që u apostrofuan më lartë, vlerësoi se prej se ka marrë mandatin si kryetar i komunës ka vu rregull, duke filluar nga vendosja e laurës tek hyrja e komunës, vizimi i parkingut të komunës, pajisja me veshmbathje e sigurimit të komunës uniforma e tyre, mbjellja e luleve duke krijuar një ambient të mirë dhe këto kanë bërë që komuna të krijoj një identitet dhe të ketë dinjitetin e një institucioni shtetëror, andaj nuk duhet pasur ngarkesa nga askush që këtë suksese të mirëpriten dhe të pranohen. Zyra përfundimisht shërbime përfundimisht diasporën që ofron shërbime edhe të shtunave përfundimisht bashkathtarët tanë janë suksese të kësaj qeverie e të cila duhet pranuar nga të gjithë sepse ai është kryetar i të gjithëve. Pastaj prej se ka marrë mandatin si kryetar i komunës, nuk përmenden byrot- projektuese, që kushtëzoheshin dikur se nëse nuk bëhet projekt i një ato zyre nuk do të pajisen me leje ndërtimore. Prej se kanë ardhur

këta drejtor të drejtorive, janë shpejtuar ofrimi i shërbimeve në Drejtorinë e Kadastrit nuk pritet për shërbim më shumë se tre ditë, ai çdo ditë fillon punë në ora 8:00, në ora 7:00 pinë kafen në sheshin e qytetit i cili pastrohet çdo të dytën ditë. Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm përsërit edhe atë që ka deklaruar në media, se i ka ofruar gjithë logistikën kompanisë, duke përfshirë edhe inspektoret e komunës, për ti zënë shpërdoruesit e ujit, por nga kompania është kërkuar përgjegjësi dhe ti lënë anash justifikimet, andaj edhe gjendja është përmirësuar. Në këtë kontekst njoftoi se ka lokacione ku rrjeti i ujësjellësit është lëshuar në përdorim pa pranim teknik dhe kompania tani nuk e merr në menaxhim këtë rrjet në rajonin e artakollit. Në fshatin Sfaraçak është prerë shiriti dhe janë lidhur pompat me tela të ndriçimit. Mandej pa dashur të polemizon, Qendra e Mjekësisë Familjare është dashur të lëshohet në funksion sepse për të është prerë shiriti, është prerë shiriti edhe për sallën e sportit në shkollen SH.M.U.1, edhe për çerdhen tek shkolla "Ali Kelmendi". Lidhur me subvencionet në bujqësi, s'kemi se çka të flasim sepse krejt e dinë se si janë shpërndarë ato, nga e kaluara, ndërsa tani ka pasur katër takime me fermerë, dhe kur ata ka deklaruar se kah dëshirojnë ti orientojnë subvencionet atëherë komuna i ka aprovuar kërkesat e tyre për orientim të investimeve, kësisoj për herë të parë subvencionet toka në sistem të ujites për 50 %, për herë të parë subvencionet qumështi me 4 cent për litër dhe në këto forma nuk ka mundësi manipulimi. Po ashtu për herë të parë do të subvencionohen bletët për koshere, dhitë dhe delet për kokë. Në arsim janë ndarë 400 bursa për profile të ndryshme, dhe mënyra e tij e qasjes në arsim është e sistemit dhe metodës kapitaliste, përgatitja profesionale për tregun e punës dhe subvencionimi i bizneseve të reja. Për sa i takon konkurseve në arsim, vlerësoi dhe pyeti anëtarët e LVV-së se keni dashur që të vazhdohet avazi i tyre i instalimit i veprimeve nepotike i punësimit të grave dhe vëllezërve siç ka ndodhur më herët, dhe njoftoi se pikërisht për të shmangur nepotizmin kishte anuluar konkursin në arsim. Në fund tha se për të gjitha të gjeturat në komunë ftoj opozitën që ti shpërfaqin, dhe vlerësoi se në qeverinë aktuale do të ketë defekte, por gjërat e orkestruar nuk do të lejohen, nuk do të lejohen dukurit e nepotizmit dhe korruptionit dhe se ai nuk lejon dhe nuk pse të jetë i shantazhaur.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** –tha se çdo kritikë që adresohet në drejtim të kryetarit dhe qeverisë së tij nuk ka të bëj me aspektin personale, por me një kritik të shëndosh për përmirësim e gjendjes, dhe shtoj se nga fillimi si grup kanë qenë korrekt dhe për çdo punë të mirë do ta kenë përkrahjen e tyre. Por edhe kur ka kritika ato duhet marr si pozitive dhe me argument politik. Sa i përket çështjes së konkurseve në arsim, ceku se nuk ka pasur vullnet për debat pasi seanca e jashtëzakonshme qëllimi është dështuar, dhe në seancën e rregullt nuk është proceduar kjo pikë për debat për shkak të mbivotimit. Nga ajo çka ka përcjellë profilin e kryetari si person që është marr me arsimin më herët dhe që ka deklaruar se e ka prioritet arsimin, nuk është dashur të mungoj gatishmëria për të pasur debat për arsimin. Në fund përsërit se për çdo punë të mirë që do të bëj qeveria e komunës do ta ketë përkrahjen e tij dhe grupit kuvendar të LVV-së, por do të jenë të pa kompromis në kritikë për punët jo të mirë dhe që janë në dëm të interesit qytetar.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –tha se nuk duhet ngatërruar kritiken parimore politike me jetën personale dhe gjërat personale, sepse kritika e tyre aludojnë në përmirësimin e gjërateve në komunë e jo me jetën personale të dikujt. Ai vlerësoi se autoriteti i tij nuk ka qenë i njojur edhe më herët dhe ndoshta është zgjedhur prej se ka hyrë në politikë, ndërsa dikush përmes politikës pretendon të bëjë autoritet dhe kjo është një dallim i madh.

**Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së** –vlerësoi se shpesh herë perceptimi është i vërtetë edhe pse nuk e pasqyron të vërteten. Më tej duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit Sylejman Meholli, shtoi se replika e tij ka të bëjë ekskluzivisht me të, pasi që ky i fundit ka lansuar të pavërteta duke i përsëritur seancë pas seance lidhur me mëditje për vizitën për homazhe në Kukës.

Në këtë vizitë ka qenë i autorizuar i kryetarit të komunës, pozicion që z.Meholli e ka ëndërruar dhe e ëndërron por që nuk ju ka dhënë rasti që ta ketë. Pozicionin e tij si ushtrues detyre i kryetarit të komunës, nuk e ka kërkuar ai por është vlerësuar nga të tjerët dhe për këtë është mirënjohës. Më tej deklroi me përgjegjësi të lartë njerëzore, politike, morale dhe penale se asnje cent nuk ka marrë nga vizita në Kukës, edhe pse z.Meholli ka hulumtuar dhe është munduar të gjiej diçka por ka dështuar, ai të pa vërtetat po mundohet ti paraqes si të vërteta por nuk po ka sukses. Pastaj njoftoi se z.Meholli, ka kërkuar zyrtarisht vendimin dhe listën e mëditjeve për vizitën në Kukës, gjë e cila ligjërisht është e lejuar por nga këto nuk është gjetur emri i Albanez Tahirajt si përfitues i mëditjes për këtë vizitë. Pastaj shtoi se në kaluarën po edhe tani ka gjuar respekt për z.Meholli dhe ceku se ky i fundit kishte pasur vlerësimë maksimale pozitive për personalitetin e tij. Në këtë relacion ai kërkoi nga anëtarë i kuvendit që ta mund urrejtjen e tij, të jetë kreativ dhe të reflektoj pozitivitet për të zhvillua ura bashkëpunimi. Në vazhdim ai vlerësoi se nuk është mirë të dezinformohet opinioni publik, me të pa vërteta, dhe njoftoi se anëtarë i kuvendit në pozitën e Drejtoritë të Shëndetësisë dikur z.Meholli kishte marrë mëditje dhjetëfish më të larët në pikun e pandemisë atëherë kur corona-virusi kishte rrezikuar të ardhmen e njerizimit dhe kjo tregon se sa i shqetësuar për buxhetin e komunës ka qenë në atë kohë z.Meholli. Pastaj në kohën kur kishte shërbyer si zyrtar i KKZ-së kishte marrë ekstra repzentacion, (pije, ushqim dhe mbushje telefoni), edhe për kundër pagës së plotë që ka marrë atëherë. Ilegalisht z.Meholli ishte angazhuar në punë në fushën e arsimit në Mitrovicë në kohen kur ka shërbyer si drejtor komunal. Me fjalë të tjera z.Meholli është ekspert i përfitimeve personale, se është katalizator, ideator dhe implementues i piramidës nepotiste kjo tashmë nuk përbën lajmë. Për sa i përket të arrestuarve të fundit në QKMF, ata kanë qenë të përkëdhelurit e tij si ish drejtor i DSHP-së dhe me ta dikur premtoste reforma në shëndetësi, ata kanë qenë mbështetësit personal tuaj dhe janë graduuar nga ana juaj. Këtë gjuhë të ashpër të urrejtjes që po e demonstron në kuvend nuk e proklamon edhe në rrjete sociale, veçanërisht je më i ndjeshëm në Snapchat. Në fund tha se nëse ky njeri moralizon për një qeverisja të mirë e të pastër, atëherë pse mandatin në qeverinë e kaluar nuk e dorëzonte, kur kemi pasur në atë qeveri plotë afera korrutive, por zëri i tij kritike atëherë nuk është dëgjuar fare sepse ka qenë i veshur me privilegjet e pushtetit.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** –duke ju adresuar qytetarëve të komunës, shtoi se edhe për kundër konstruktivitetit që ka ai dhe grapi kuvendarë i tij, është instaluar në kuvend gjuha e urrejtjes dhe tashmë foltorja e kuvendit por përdoret në mënyrë abuzive për ti damkosur kundërshtarët politik me të pa vërtet dhe fatkeqësisht kjo po mundësohet edhe nga kryesuesja e kuvendit që po lejon diskutime pa limit në kohë në mënyrë kundërligjore. Pastaj shtoi se ai në mbledhjen e KPF-së dhe të kuvendit zyrtarisht kishte kërkuar informacion me shkrim për, mëditje përvizitën në Kukës por këtë informacion nuk e ka pranuar asnjëherë. Tute shtoi se është i pavend ndërlidhja e temave që po tentohet të bëhet mes kohës kur ka qenë drejtor, kohë për të cilën është shumë krenar me punën që ka bërë në shëndetësi dhe me të arriturat. Lidhur me këtë njoftoi se Komuna e Vushtrrisë ka qenë prej të vetme në nivel Republike që si autoritet komunal është përfaqësuar në Konferencën Evropiane të Menaxhmentit Shëndetësor në qershor të vitit 2019, ndërsa pandemia ka filluar me 31.12.2019 dhe për këtë duhet ti rifreskoni aftësitë tuaj të shëndetit publik. Të ulet niveli i debatit deri në këtë stad është tepër e papranueshme dhe krejt këtë e përmbylli me një thëne: <fol ç't duash me sharje në çështjen time, sepse heshta ndaj të ligut është përgjigje, jo se më mungon përgjigja ndaj teje, por nuk besoj që luani i jep qenit përgjigje>.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**–tha se nëse në diskutimet e tij dikë e ka lënduar publikisht kërkon falje, dhe shtoi duke ju referuar anëtarit të kuvendit z.Meholli se kur të qetësohet le ta analizoj paragrafin që e citoj më lartë dhe ta diskutoj edhe me shokët e tij sepse nuk është në rregull që

flitet me këtë gjuhë. Pastaj sqaroi se për debatin për arsimin është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme, dhe mandej ata që vetë i ka thirrur grupi kuvendar i LVV-së janë vonuar por si kryetar i komunës ka qenë i gatshëm të diskutoj për atë çështje pasi që nuk ka asgjë për të fshehur, sepse ai po del që si kryetar i komunës është duke e luftuar nepotizmin. Lidhur me vizitën në Selanik që ka bërë tek shtëpia e Hasani Prishtinës, dhe në këtë rast të gjitha shpenzimet e vizitës i ka mbuluar personalit vetë, dhe nuk ka marr mëditje. Në fund tha se nuk ikje nga debati për asnje temë, dhe vlerësoi se duhet diskutuar pa emocione dhe me argumentet e jo të sulmohen njerezit-zyrtaret vetëm pse mbajnë një pozitë publike.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** –tha se bazuar në rregulloren e punës të kuvendit, diskutimet para rendit të ditës bëhen për interes të përgjithshëm qytetar, për çështjet që nuk janë të përfshira në rend dite, por po shihet se kjo e drejtë po keqpërdoret duke diskutuar çështje puro politike dhe për sulm politik ndaj njëri tjetrit, kjo duhet të anashkalohet dhe ti kthehem i diskutimit përbajtsor në interes qytetar dhe për çështje që janë objekt shqyrtim në rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grüpuit kuvendar të PDK-së,** paraqiti shqetësimin e tij për gjuhen që po përdoret në kuvandin e komunës dhe kërkoi nga z.Sylejman Meholli të kërkoi falje publike për fyerjen që bëri ndaj anëtarit të qeverisë komunale, kërkim falje bëri edhe kryetari i komunës edhe pse nuk fyejti askënd me diskutimin e tij. Është kulturë elementare që kur bëhen gabime të kërkohet falje, dhe në bazë të rregullores pas kërkjesë nëse nuk kërkohet falje janë procedurat që duhet të zbatohen ndaj anëtarëve të kuvendit, dhe nëse kjo nuk ndodh atëherë kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që të zbatoj rregulloren e punës të kuvendit.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** –kërkoi nga anëtarë i kuvendit z.Meholli, që ta tërheq fjalën fye se që pati në diskutimin e tij.

**Ali Januzi, anëtar e kuvendit-vlerësoi** se kur diskutojmë duhet të kemi një kulturë debati dhe dialogu pa përjashtim nga të gjithë. Mandjej shtoi se asnje qeveri dheasnje parti politike nuk është perfektë dheasnje qeveri nuk mund ti plotësoj të gjitha kërkuesat. Në këtë rrafsh vlerësoi se në kuvend është instaluar një kulturë jo e mirë punës, ku kemi sulme me gjuhë të ashpër ndaj njëri tjetrit, kjo nuk është në rregull, nëse kemi argumente për ndonjërin për veprime të palejueshme atëherë ato duhet të ia themi në tavolinë ballë për ballë por jo të akuzojmë pa fakte. Lidhur me anëtarin e kuvendit z.Meholli tha se është njohës i mirë i çështjeve dhe jep një kontribut të çmuar, por ai duhet të jetë i kujdeshëm dhe i kërkoi që ta tërheq fjalën fye se që e potenco më lartë, dhe po se bëri ai kërkim faljen ai vet do ta bëj në emër të tij.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se nuk gjë e ligë dhe tragji-komike të kërkosh fjalë, bile është fisnikë, por ai ceku se më herët citoj një thënie të një autori tjetër e jo ai, por nga kjo kushdo që nden ofendim nga kjo thënie ai e tërheq atë fjalë dhe kërkon falje, dhe kërkoi që në përgjithësi mos të krijohen kësi lloj precedente e aq më pak drejtorët të marrin fjalën dhe të gjuajnë kësi lloj helmi në debat deri në shpifje, e për këto shpifje dikush tjetër duhet të kërkoi falje sepse në të kundërtën duhet të shkohet përmes instrumenteve tjera në organet përkatëse.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –ngrit shqetësimin e ndërprerjes në masë të madhe në këto ditë vape të energjisë elektrike, dhe pyeti kryetarin e komunës se a ka pasur takim me përfaqësuesit e KEDS-it që operojnë në Vushtrri, me qëllim informim për këtë problematike dhe për njoftim se a kanë ndonjë planë operativ për sigurimin e furnizimit më të mirë me energji elektrike. Ndërsa çështja tjetër që ngriti është ajo e gjuhës së ashpër dhe denigruese që po përdoret në kuvendit, dhe në rastin konkret nuk ishte vetëm nga ana e asamblistit por edhe nga ana e drejtorit të kësaj qeverie, në këtë drejtim kërkoi që të gjithë të përbahen nga gjuha e urrejtjes dhe sulmit ndaj njëri tjetri duke mbrojtur sidomos anë e gjërave personale. Më tej shtoi dhe vlerësoi jashtëzakonisht lartë punën dhe aftësitë e bashkë partiakut të tij Sylejman Meholli për të cilin tha se e ka bërë dallimin

në punën e qeverisës së kaluar dhe për këtë gjë ata krenohen. Mandej lidhu me punën e tij ai sqaroi se angazhimi i tij në KKZ, mandej si mësimdhënës në Mitrovicë, kanë qenë detyra legale dhe të deklaruar për tatim në ATK, andaj nuk është mirë që drejtori Albanez Tahiraj të jetë kaq i njëanshëm dhe i ngarkuar politikisht dhe se sulmet dhe ofendimet ti ndalë së vazhdhari. Në fund thirri për bashkëpunim dhe frysë mirëkuptim mes subjekteve politike.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-njoftoi** se ka pasur takim me përfaqësuesit e KEDS-it, para dy tre ditësh, edhe pse kërkesa ka qenë më herët, temë diskutimi kanë qenë kyçja në rrjetin energetik e disa institucioneve si çerdhet, mandej pompat e ujësjellësit që do të lëshohen në përdorim, madje i është prezantuar një listë e nevojave të fshatrave për trafo dhe shtylla elektrike, ndërsa premtimi i tyre ishte se rreth një milion euro do të investohen në rrjetin elektrik në Komunën e Vushtrrisë. Ndërsa në kuadër diskutimeve për rendin e ditës kërkoj që pika 11 të hiqet nga shqyrtimi propozim-vendimi për Parkun Industrial në Lumadh, kjo për faktin se për këtë çështje është themeluar një komision dhe për këtë duhet të pritet raporti i komisionit për këtë çështje.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me “unanime” aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 qershor 2022;
  2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022;
  3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-statutit të Komunës së Vushtrrisë;
  4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021;
  5. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
  6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022;
  7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përgjedhjen e këshillave lokale;
  8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit;
  9. Shqyrtimi i Propozim – vendimi për transferin e mjeteve financiare të komunës;
  10. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit për përkrahje financiare;
  11. Shqyrtimi i planit për vlerësimin e rezikut në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
  12. Shqyrtimi i Propozim – vendimi për ngritje të lartësisë së pagesës së mjeteve financiare për shërbimet e kryera nga K.R.M. “Uniteti” SH.A në Mitrovicë ndaj Komunës së Vushtrrisë;
  13. Informatë për gjendje e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë;
  14. Shqyrtimi i kërkesës të Bashkësisë Lokale të fshatit Stanoc për rregullimin e varrezave për dëshmorët Sadri Mala dhe Sadik Mala;
  15. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 qershor 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 qershori 2022.**

**2. Shqyrtim i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershori 2022;**

**Fatmire Cecelia, anëtar e kuvendit-tha** se në informatë për gjendjen e sigurisë konstatohet se gjendja e sigurisë nëpër shkolla është e mirë, ndërsa më tej thuhet se në një aksion për kontroll në një shkolla tek nxënësit janë gjetur dhe sekuestruar 7 thika, 1 bokës hekuri 1 pistoletë nga plastika dhe gjësende tjera. Në këtë rrafsh nuk e di se si mund të cilësohet siguria e mirë nëpër shkolla kur vetëm nga një aksion konfiskohen gjithë këto armë të ftohta dhe gjësende tjera.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-ngriti** shqetësimin e tij dhe të qytetarëve se në rrugën “Pandeli Sotiri ” apo siç quhet rruga tek kafet e vogla afër shkollës së mesme, ku bizneset kanë njoftuar se shiten në mënyrë të lirë substanca narkotike, në atë pjesë ka edhe frekuentim të madh të të rinjve, dhe gjasat për këto dukuri janë të larta, andaj kërkoj një bashkëpunim më të intensifikuar mes autoritetave policore dhe atyre të komunës me qëllim të parandalimit të këtij aktiviteti. Si parandalim dhe kontroll më të mirë ta asaj zone do të ishte instalimi i kamerave, ku do të lehtësohej identifikimi i atyre peronave dhe parandalimi i aktivitetit të paligjshëm.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha** se është shqetësuese fakti i gjetjes së armëve të ftohta tek nxënësit e shkollave të mesme, dhe për këtë aksionet e policës duhet të jenë në vazhdimësi, në mënyrë që të rritet siguria nëpër shkolla, dhe vlerësoi se deri më tanë kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë mes zyrtarëve policor dhe drejtues të shkollave në Komunën e Vushtrrisë dhe ky bashkëpunim duhet vazhdoj dhe të intensifikohet edhe më tej. Më tej ai ngriti shqetësimin e banorëve të zonës së Çiçavicës konkretisht të fshatit Duboc, ku disa grup të rinjsh orëve të vona të natës po lëvizin me vetura pa targa e në disa raste ka pasur edhe ndalim të qytetarëve dhe iu janë grabitur gjësende të ndryshme për këtë pyeti kapitenin se a janë në dijeni organet policore dhe nëse po a janë ndërmarr masa.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti** se a ka ndonjë të akuzuar për rastet e zjarrvënieve të qëllimshme nëpër lokalitet e ndryshme të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifë, kryesuese e kuvendit-adresoj** shqetësimin e banorëve të fshati Bukosh për zhurmë të lartë nga disa lokale të natës, për këtë kanë kërkuar të përcillet koha deri sa kanë të drejtë këto lokale të janë të hapura dhe të kontrollohet niveli i zhurmës. Mandej shoti dhe kërkoj nga organet gjegjëse për të mbajtur rregull për sa i përket shfrytëzimit të vendkalimeve dhe trotuareve me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion. Po ashtu vlerësoi lartë bashkëpunimin mes polisës dhe shkollave të komunës dhe kërkoj që ky bashkëpunim të intensifikohet.

**Reshat Kovaçi, komandant i Stacionit Policor-** paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me reportin duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-statutit të Komunës së Vushtrrisë;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendit sqaroi se komisioni satatutar i themeluar me vendim të kuvendit me suksese ka përfunduar punën e tij për hartimin e statutit të komunës dhe me qenë se kemi të bëjmë me ndryshime me tepër se 30 % të statutit aktual, është**

bërë hartimi i statutit të ri të komunës. Ai falënderoj anëtarët e komisionit për kontributin e dhënë dhe çmoj se çështja që më së shumit i ka zgjuar debat është ajo e themelimit të drejtorive komunale të parapara me nenin 51. Me këtë nenë në mënyrë unanime nga komisioni është vendosur që tavani i numrit të drejtorive të jetë më së tepërm 14 drejtori komunale, ndërsa ndryshimi tjetër është se kompetencat dhe përgjegjësit duhet të përcaktohen me vendim të veçantë të kryetarit të komunës, dhe ato së bashku me organogramin e komunës duhet të prezantohen në mbledhjen e parë të rregullt të kuvendit nga ana e kryetarit të komunës. Më tej shtoi se fleksibiliteti në formimin e drejtorive komunale, duhet të ekzistoj përfaktin e mundësisë së adaptimit më të mirë të kërkesave të kohës me zhvillimet aktuale në tregun e punës, teknologjisë informative dhe çështjeve tjera në kuptimin e ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët. Në fund kërkoj që statutit të votohet me vota unanime sepse është nevojë imediatet e kohës me qëllim të harmonizimit të këtij statuti me ligjet tjera dhe përfaktin se ky statut nuk është duke u bërë vetëm përfnjë mandat por përbëhet për zhvillim në staza më të gjata të Komunës së Vushtrrisë.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha** se është mësues që është hartuar statuti i ri i komunës, pasi që kemi shumë dispozita të statutit aktual që janë të vjetruar dhe nuk janë në harmoni me ligjet tjera. Më tej shtoj se ky akt nuk i ka kaluar të gjithë hapat ligjor sepse dej është thirrur mbledhja e KPF-së si mbledhje e jashtëzakonshme për shqyrtimin e këtij draft-statutit, e që ligjërisht nuk është në rregull pasi legjislacioni nuk njeh mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së por vetëm të kuvendit. Pastaj shtoi se si grup i LDK-së nuk janë kundër aprovimit të statutit, por nuk e kuption se përsë gjithë kjo nguti që sot të aprovohet ky dokument, dhe se në këtë nuk është paraparë askund *shkarkimi i kryesuesit/se* të kuvendit, nuk janë kundërritjes se numrit të drejtorive, por nëse i hiqet kuvendit kompetenca për emërim të drejtorive, atëherë duhet të jenë të parapara disa drejtori bazë që i parasheh komuna pavarësisht se kush do të jetë kryetar i komunës nesër. Pastaj dëgjimet publike përkëtë statut kanë qenë deri dje me 27 korrik 2022, komision është dashur që sot të sjell para kuvendit një raport që evidenton se cilat kanë qenë sugjerimet e qytetarëve të Vushtrrisë sepse sipas informatave ti tij dëgjimi me qytetar nuk është mbajt fare. Në fund tha se statuti i komunës duhet të aprovohet me vota unanime, por sot mendon se nuk është një rast i tillë andaj kërko që kjo pikë të shtyhet për ndonjëren nga mbledhjet e radhës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-njoftoi** se dëgjimi publik me qytetar për statutin e komunës është mbajtur dhe ka qenë njoftimi publik përkëtë ka qenë në mjetet e informimit publik, mirëpo nuk ka pasur pjessëmarrje të qytetarëve, përmë tepër ka pasur propozime të ndryshme që janë dërguar në adresë elektronike të cilat ato që kanë qenë të arsyeshme dhe të ligjshme janë inkorporuar në statut. Andaj lidhur me këtë janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për debatin publik me qytetar për statutin dhe se të gjitha organet e komunës janë paraparë forma e zgjedhjes dhe e shkarkimit. Ndërsa zgjedhja dhe shkarkimi i kryesuesit të kuvendit është paraparë me udhëzimi administrativ. **Ferit Idrizi, kryetar i komunës-pasi** falënderoj komisionin kuvendar përpunën që kanë bërë në hartimin e statutit të komunës, vlerësoi se kishte më qenë më mirë nëse kishte me pas më shumë propozime nga anëtarët e kuvendit dhe pjesëmarrës në diskutimin publik. Tështo se ka pritur nga anëtarë e kuvendit që do të jepin propozime dhe do ta shqyrtojnë nenë për nenë këtë statut. Aprovimi sot i statutit të komunës është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse kemi shumë rregullore edhe është kohë e gjatë që nuk është ndryshuar statuti, ka nevojë që të harmonizohet me ligjet tjera dhe i njëjtë ti përshtat kushteve dhe rrethanave që po jetojmë. Pastaj shtoi se dilema që shumë anëtarë të kuvendit po e ngritin është tek nenin 51 e drejta përti themeluar dhe numri i drejtorive komunale, sipas mendimit të tij në çdo sistem ekzekutivi është ai që vendos për

dikasteret me të cilat do të funksionoj. Mandej vlerësoi se është më mirë të kemi fleksibilitet në përcaktimin e drejtorive komunale mos të jemi të kufizuar ashtu që kryetarit të komunës ti mundësohet të performoj sa më mirë. Nuk është qëllimi i fuzonimi të drejtorive, ndërsa mund që përshkrimi i detyrave dhe kompetencave të propozohet nga ekzekutive ndërsa të aprovohet në kuvend, por pa u prekur statuti i komunës, ku përcaktohet se numri i drejtorive do të jetë deri në 14. Në vazhdim vlerësoi se disa nene nga statuti i kaluar janë hequr fare, pasi që në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale janë paraparë këto nene dhe qellim ka qenë që mos te ketë përsëritje të normave juridike. Synimin e përfleksibilitet të normave statutare sa i përket numrit të drejtorive komunale, e shpërfaqi me shembullin e ndarjes së bursave për studentët, ku këtë vit është rritur numri i bursave në 70, dhe për ti jap burra drejtimeve deficitare, në rregullore është paraparë që kriteri të jetë nota mesatare 8.5, dhe më në këtë rast më e logjikshme do të ishte të jetë vetëm nota mesatare, dhe në rastin konkret nëse ke 100 studentë ti nuk mundesh ti kesh që të gjithë me notë mesatare 8.5 e më shumë, andaj këtu qëndron poenta e mos kufizimit me norma juridike dhe aplikimi i fleksibilitetit në përkufizimet ligjore. Në fund kërkoj nga anëtarët e kuvendit pa dallim subjektit politik që ti japid propozimet dhe ta votojnë aprovimin e statutit me vota unanime.

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit** –tha se është e nevojshme që statutit i komunës të ndryshohet dhe të plotësohet, pasi që shumë gjëra duhet ti përshtaten rrethanave dhe ligjeve të reja. Më gjithë këtë duke parë që statuti i komunës është një lloj kushtetute për komunën si akti më i lartë juridik i komunës, dhe me qenë se për aprovimin e tij nevojiten 2/3 e kuvendit është dashur që paraprakisht të mbahet një tryezë e përbashkët. Duke parë peshën që ka statuti i komunës që pretendohet të ketë një jetëgjatësi juridike për disa mandatet, aprovimit të tij do të duhej ti paraprinte një debat më i gjerë e substancial në qarqe të ndryshëm deri në finalizim, kjo nuk ka ndodhur dhe tanë nuk mendon se është momenti i duhur për aprovimin e këtij statuti. Statuti i komunës duhet të jetë konform rrethanave që i përshtatet zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të gjithmbarshëm të Komunës së Vushtrrisë. Ka qenë tepër e nevojshme që paraprakisht të ftohen shefat e grupeve kuvendar për ti harmonizuar qëndrimet dhe për të pasur një dakordancë. Shikimi vetëm tek simbolika e numrit të drejtorive komunale sikur po e zbeh shqyrtimin dhe analizën e neneve të këtij statuti e që janë tepër me rëndësi të shqyrtohen hollësishët pasi që vetë statuti është akti më i rëndësishëm i komunës. Nëse sot ka vullnet që të qitet në votim atëherë është mirë të merret një pauzë që të gjendet një zgjidhje duke mos e politizuar këtë çështje pasi që statuti është akti juridik por i njëjtë ka edhe karakter politik në kuptimin se çfarë platforme do të ofroj një qeverisje, andaj vlerësoi se anëtaret e kuvendit janë plotësisht të lirë që të vendosnin për votimin për ose kundër aprovimit të këtij statuti.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se nëse ky statut ka gabime atëherë ato duhet të ceken dhe të përmirësohen, dhe shtoi se nuk është mirë që për inate politike të bllokohen proceset, sepse tek e fundit statuti bëhet për komunën e jo për parti politike që do të ndërrohen në pushtet. Në këtë kontekst kërkoj një pauzë që të gjendet një zgjidhje oportune.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit**-tha se pasi që ky statuti nuk është i harmonizuar si duhet, le të shqyhet kjo temë për mbledhjen e ardhshme.

**Shpëtim Zhegrova, nënkytar i komunës**-tha se është krejt e arsyeshme që të mbahet një pauzë, për gjetjen e një zgjidhje, por nuk ka arsyet që kjo pikë të shtyhet pasi që ky statut është hartuar në bashkëpunim me të gjitha subjektet politike sepse në komision kanë qenë të përfaqësuesit e këtyre subjekteve politike në përgjithësi, madje statuti i ka përfillur të gjitha hapat ligjor duke mbajtur diskutimin publik dhe tanë ai duhet ose të aprovohet ose të kundërshtohet. Lidhur me idenë e një takim mes subjekteve politike, vlerësoi se para mbledhje së kuvendit është mbajtur takim i

Komititetit për Politikë dhe Financa që është filtri kryesor i kuvendit dhe që i paraprinë punës së kuvend, e në cilin janë të përfaqësuara të gjitha subjektet politike.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të PDK-së njoftoi se pas konsultimeve që patën me shefat e grupeve kuvendar, nuk u arrit ndonjë dokordim, dhe shtoi se si grup kuvendar janë të pajtimet që statuti të del në votim, ndërsa nëse partitë tjera opozitare janë të pajtimit që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës duke u organizuar ndonjë tryezë e konsultimit mes subjekteve politike atëherë e përkrahnin këtë ide. Në këtë kontekst pret që subjektet politike opozitare ti deklarojnë qëndrimet e tyre se për cilin opsion janë të përcaktuara.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**- në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozon që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LVV-së, vlerësoi se është rregull që propozuesi i aktit ta qet në votim propozimin, ndërsa mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit se a do ta përkrahin një pikë të tillë të rendit të ditës.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha** se është i pajtimit që ky draft-statut të procedohet për votim, me plotësim që e propozoi anëtari i kuvendit z. Adnan Lahu, që të futet teksti për shkarkimin e kryesuesit të kuvendit, sa i përket numrit të drejtoreve komunale të kemi një fleksibilitet që numri i tyre të jetë jo më shumë se 14 drejtori. Më tej kërkoi të evidentohet se nuk mund të shtohet numri i drejtoreve pa planifikim të buxhetit, kjo do të thotë se në gjysmë të vitit fiskal askush nuk mund të iniciojë themelim të drejtoreve të reja. Mandaj shtoi se është imediatet ndoshta funksionalizimi i zyrës për projekte, mandaj themelimi apo ndarja e Drejtorisë së Bujqësisë por edhe sektori i turizmit të futet në Drejtoren e Zhvillimit Ekonomik. Ai deklroi se mirë kishte me qenë që ky statut të aprovohet dhe filtrohet nenë për nenë ashtu që të kemi një akt juridik të qartë dhe të zbatueshëm. Numrin e drejtoreve komunale e cakton kryetari i komunës jo më shumë se 14 drejtori, ndërsa përshkrimin e detyrave të drejtorisë e propozon kryetari i komunës ndërsa aprovimi bëhet në kuvend të komunës.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** -tha se dikush e përmendi bllokimin e proceseve, por në realitet nuk ka kurfarë bllokimi të proceseve pasi ne e kemi statutin e komunës që është në fuqi. Pastaj shtoi se kur bëhet ndryshimi i një akti siç është statuti i komunës duhet pasur parasysh që të kemi një strukturim dhe organizim më të mirë komunal, dhe pyeti se vërtet a po bëhet një gjë e tillë për këtë qellim, apo problemi ekziston diku tjetër tek koalicionet politike tek emërimi i dy drejtoreve të ri, ashtu siç ka qenë marrëveshja politike më herët dhe premtimet që janë dhënë më herët.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se duhet të ketë korrigjim të nenit 3 të draft-statutit sa i përket selisë së komunës në tekstin si në vijim: selia e komunës gjendet në Vushtrri, Sheshi "Ahmet Krasniqi Nr.10", po ashtu draft-statuti duhet të aprovohet me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku përfshihen propozimet e Haki Malokut dhe një propozim i Jeton Salihut.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-deklaroi** se Nisma-Socialdemokrate e përkrah dhe e voton draft-statutin e Komunës së Vushtrrisë, për arsy se ky akt është në interes të përgjithshëm. Ndërsa kërkoi sqarim se në procesverbalin e takimit të komisionit statutar ka kundërthënie sa i përket propozimeve të bëra nga përfaqësuesit e subjekteve politike.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-kërkoj** nga subjekti i tij politikë që ta përkrahin me votë aprovimin e draft-statutit të komunës, sepse siç deklaroi sa herë që i ka latur për diçka dhe nuk e kanë dëgjuar asnjëherë nuk kanë pasur leverdi, e kjo kishte ngjarë me mos lidhjen e koalacioneve. Kërkoj që ata të veprojnë duke e votuar statutin sepse kjo është formë demokratike.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota “për” 9 vota “kundër” 2 anëtarë të kuvendit nuk morën pjesë në votim, nuk e aprovoj Draft-statutin e Komunës së Vushtrrisë.**

**4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021;**

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të rapporti të auditorit opinioni për pasqyrat financiare vjetor të komunës është i kualifikuar dhe janë dhënë argumentet dhe baza për këtë opinion. Në këtë raport thuhet se llogaritë e arktueshme janë nënvalorësuar për vlerën 199,290.00€, saldot për taksen për menaxhimin e mbeturinave janë nënvalorësuar për 158,692.00 €, saldot për shfrytëzimin e pronës publike janë nënvalorësuar prej 40,598.00 €. Pastaj thuhet se kemi keq klasifikim për kategoritë ekonomike në vlerë prej 148,241.00 € prej tyre 94,601.00 € nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar mallra dhe shërbime dhe 53,640.00 € nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar subvencione dhe transfere. Pra kemi edhe konkluzion për pajtueshmëri dhe baza për konkluzion është mos vazhdimin i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës në vlerë 303,273.00 €. Angazhimi i punonjësve pa procedurë për shërbime të veçanta në vlerë 150,071 €, janë punësuar 141 punonjës në kohën e fushatës paralektorale për zgjedhjet komunale 2021, në periudhën nga muaj tetor deri në dhjetor 2021. Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor në vlerë 90,357 €. Vlerësimi i tenderit për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, në vlerë të kontratës 94,121 € ishte përzgjedhur kompania që nuk ka plotësuar kriterin për inxhinier të elektroteknikës të drejtimit tension i ulët. Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblerjes në vlerë 37,908 €, ishin jo në pajtim me rregullën financiare nr.01/2013. Në kontratën për kryerjen e shërbimeve komunale, janë paguar 5,368 € më shumë se sa shuma mujore e përcaktuar me marrëveshje. Nëse këto shuma që janë vetëm 1/3 që janë evidentuar në këtë raport të auditorit i kalkulojmë del se janë 1,28,000.629 € para të tak sapaguesve-qytetarëve të komunës sonë të cilat janë keqpërdorur. Zyra Kombëtare e Auditimit gjegjësisht auditori ka identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e keqdeklarimit material të pasqyrave financiare qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Auditori ka potencuar se rreziku i mos zbatimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i madh se sa ai që rezulton nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshij manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqsim ose anashkalim të kontratave të brendshme. Auditori po ashtu ka konstatuar se Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar në nivel shumë të ulët buxhetin në vitin 2021 për investime kapitale vetëm 68 % dhe prej kësaj del se 32% e buxhetit ka mbetur e pashpenzuar për vitin 2021. Këto të gjatura të konstatuara në reportin e auditorit janë tepër shqetësuese, dhe kërkoj që ky raport të procedohet në organet e hetuesisë ashtu që drejtësia ta thotë fjalën e fundit sepse vërehen që kemi shumë keqpërdorime të parasë publike dhe taksave të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.**

**5. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 19 vota “për” aprovoj reportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.**

**6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022;**

**7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale;**

**Hava Mlinaku, drejtoreshë e DA-së-paraqiti** sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë duke elaburuar dispozita juridike që rregullojnë përbërjen dhe kompetencat e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-** anëtar i kuvendit-kërkoi nga komuna, përkatësisht drejtore të komunal, që komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale, ti japid gjithë mbështetjen e duhur sepse ky komision ka jashtëzakonisht një punë me rëndësi dhe voluminoze.

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit** –tha se ky komision ka një punë jashtëzakonisht voluminoze, dhe vlerësoi se këshillat lokal në mandatin e kaluar, nuk janë kompensuar, ku disa prej tyre kanë zgjedhur format ligjore me padi për realizimin e kompensimit. Në këtë drejtim kërkoi nga komuna që të gjendet modaliteti ligjor për kompensimin e këshillave të fshatrave, e në të njëjtën kohë kërkoi që edhe komisioni të mbështetet jo vetëm me logistikë por edhe me mjete financiare.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim themelohet komisioni për koordinimin e procesit për përzgjedhjen e këshillave lokale në këtë përbërje:

- 1.1 Blerina Shala, anëtare e Kuvendit të komunës;
- 1.2 Agron Përçuku, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.3 Ymer Haradinaj anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.4 Bekim Zabergja, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.5 Qemajl Hasani, anëtar i ekzekutivit të komunës;
- 1.6 Isak Hyseni, anëtar i shoqërisë civile, dhe
- 1.7 \_\_\_\_\_, përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane.

2. Komisioni komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.

3. Mandati i Komisionit komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale është i lidhur me mandatin e Kuvendit komunal.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit;**

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-kërkoi** të jepen sqarime lidhur me këtë propozim-vendim, si do të bëhet zbatimi i këtij vendimi kur dihet se kyqjet bëhen nga ujësjellësi e jo nga komuna, sa është kostoja financiare, sa ekonomi familjare kanë mbetur pa u kyqur e të ngjashme. Më tej njoftoi se Komuna e Vushtrrisë ka një marrëveshje me ujësjellësin ku do të participojn edhe qytetaret për

shkak të mungesë së mjeteve financiare për zhvillimin e projektit të kyqjeve, ndërsa ujësjellësi në këtë rast liron subjekt-ekonomit familjare nga të taksa e kyqjes. Në këtë rast duhet ta dimë se kush po lirohet nga kjo takës, sepse në të kaluarën janë liruar disa kategori si veteranët e luftës, familjet me social dhe kanë qenë afër 2000 ekonomi familjare që janë liruar. Participimi i ekonomive familjare ka qenë më i lirë se sa kyqja që është dashur ti paguhet ujësjellësit.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-sqaroi** se vendimi është shumë i qartë, ku shuma prej 80 € për kyqje në rrjetin e ujësjellësit nuk do të vjelët nga qytetaret në lokalitetet ku do bëhet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit**-duke u nisur nga premisa si ish drejtor i DSHP-së, njoftoi se këtë projekt e ka ideuar dhe iniciua për realizim. Pastaj pyeti drejtorin aktual se a ka informata se edhe sa familje kanë mbet pa u kyqur në rrjet. Ndërsa shtoi se familjet me asistencë sociale, ato të veteranëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së janë liruar kohë më parë, dhe tani pse nuk shtrihet rrjeti, pse nuk vendosen pompat aty ku ka mungesë të shtypjes së ujit, po jeni ka merrni me propagandë të myktë, duke deklaruar se po lirojnë diçka që ka mbetur edhe 400 apo 500 familje për kyqje.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se të gjitha projektet që kanë mbetur nga mandati i kaluar do të vazhdohen, me përjashtim të atyre që kanë dështuar sikurse është ajo depoja e patates në fshatin Pestovë. Mandej njoftoj se do të zgjerohet rrjeti i ujësjellësit në lokalitetet ku ka mbetur pa u përfunduar dhe do të mënjanohen defektet ku kanë mbeti nga mandati i kaluar. Pastaj shtoi dhe vlerësoi se për shumë projekte për vendosjen e pompave të ujit, janë prerë shiritat, ndërsa nuk pranohen nga Kompania e Ujësjellësit sepse ka defekte, ato duhet të testohen dhe jemi duke i marr edhe pëlqimet nga KEDS-i për kyqje në rrjetin elektrik dhe më pas do të lëshohen në funksion. Ndërsa sa i përket vendimi sqaroi se ai ka shfuqizuar vendimin e kryetarit të komunës nga mandati i kaluar, për të cilën ka të drejtë juridike pas një arsyehsmërie. Ndërsa vendimin për lirim të ekonomikeve familjare bie në kompetencat e kuvendit dhe për këtë është proceduar në kuvend.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se nevoja për furnizim me ujë të pijshëm vërtet është e madhe dhe komuna duhet të angazhohet maksimalisht që zgjedhë këto probleme. Ndërsa shtoj se kur bëhet fjalë për pranim teknik të pompave të ujit, ato janë leshura në funksion për faktin se ka qenë nevojë për furnizim me ujë, por nëse e shtrojmë kështu këtë çështje atëherë pyet se fabrika e ujit që është ndërtuar para tetë viteve a ka pranim teknik, sigurisht që nuk ka, por e ka pranuar Kompania e Ujësjellësit dhe se tetë vite ka qëndruar në tokë gypi kryesor i ujësjellësit dhe kur kanë filluar punimet ai në shumë vende ka qenë i dëmtuar, por proceset nuk janë ndalua me qëllim të finalizimit të këtij projekti. Në fund tha se janë që ti ndihmojnë qytetarë por ky vendim nuk ka pasur fare nevojë të vjen në kuvend, por vetëm është dashur që komuna ti ofroj mjetet për zhvillimin e këtij projekti.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se për kyqje në rrjetin e ujësjellësit ekonomitë familjare kanë pasur të paguajnë nga 80 € ndërsa bizneset nga 150 €, andaj a do të janë edhe bizneset e liruar me këtë vendim. Pastaj sa është vlera financiare që planifikon ti paguaj komuna sepse në pikën dy të propozimit thuhet: Vlera e mjeteve financiare për pjesën e mbetur sipas kontratës me operatorin ekonomik do të paguhet nga mjetet e planifikuara me buxhetin e komunës dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, andaj me qëllim të informimit të drejt të opinionit publik duhet ditur se është shuma që ka ndarë Komuna e Vushtrisë si dhe sa do të jetë ndihma e ministrisë. Vendimi a do të ketë efekt retroaktiv, sepse vetëm në fshatin Stanoc i Epërm, janë grumbulluar 36,800 € që ai personalisht i ka dorëzuar në llogarinë e komunës, dhe atëherë është thënë që mistria do ti paguaj 300,000. €, ndërsa vetëm fshati i tij ka participuar sa 10% e mjeteve të ministrisë. Andaj nëse ky vendim nuk ka efekt retroaktiv ai ndihet shumë keq pasi që

të cilët e drejtojnë gishtin nga ai për ato mjete edhe pse të gjitha janë të argumentuara me fletë pagesa dhe me dëshmi për derdhjen e tyre në llogari të komunës. Sa i përket punimeve në përgjithësi nga ekspertët është mendimi së nuk janë kryer si duhet punime në ujësjellës. Ish kryetari i komunës nuk kishte ardhur në përrimin e lëshimit të ujit në Stanoc të Epërm, por kishte shkuar në fshatin Druar dhe jo në lagjet e larta sepse atij nuk kishte ujë por kishte ndaluar tek shkolla e fshatit dhe as aty nuk kishte pasur ujë, andaj e kishte lëshuar ujin me hidrofor sa për ta parë qytetarët.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se për aq sa është mundshme kishte me qenë mirë që ky vendim të ketë efekt retroaktiv, dhe i pëlqej kryetari i komunës që u deklaruar i sinqertë se ka probleme me ujin, sepse në fushatë kishte deklaruar se për afat prej 6 muajsh do të lëshohet në funksion uji në tërë territorin e Vushtrrisë. Ndërsa shtoi se sa mjet ka planifikuar komuna për buxhetin e vitit 2023 për finalizimin e projektit për ujë të pijshëm dhe sugjeroi që krejt mjetet financiare nga investimet kapitale të orientohen në ndërtimin dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit sepse uji nuk ka kosto.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-sqaroi** se asnjë nga pranimet teknike të pompave të ujit nuk i ka pranuar Kompania Ujësjellësi, me arsyetimin se nuk janë kryer punët si duhet. Ndërsa lidhur me vendimin për lirim nga 80 €, vlerësoi se nëse 1.6 milion euro kanë shkuar në suficit, dhe të merresh me shumën prej 80 euro kjo nuk do koment.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** - sqaroi se Kompania Ujësjellësi nuk ka bazë për ankesë sepse lëshimi i ujit në rrejti nuk ka mundur të bëhet pa u bërë pranimi teknik nga vetë kompania, ndërsa ata kanë vepruar duke e lëshuar ujin, ndërsa ish kryetari i komunës e ka shfrytëzuar rastin për të promovuar se uji është lëshuar.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lirohen ekonomitë familjare nga pagesa për kyçje e mbeturësia në rrjetin e ujësjellësit që do të realizohet në bazë të kontratës ekzistuese “zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit” të cilën është duke e implemantuar operatori ekonomik “Ilea Group” që është duke i kryer punët në terren.
2. Vlera e mjeteve financiare për pjesën e mbetur sipas kontratës me operatorin ekonomik do të paguhet nga mjetet e planifikuara me buxhetin e komunës dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Shërbime Publike si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimi për transferin e mjeteve financiare të komunës;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare në vlerë 9,319.56€ të cilat transferohen nga programi Bujqësia, Projekti bashkëfinancim me donator, kod i projektit 49561, në programin Arsimi fillor (93690) në projektin Ndërtimi i tualeteve në SHMU “Emin Duraku” kod i projektit 51854.

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi mbeten në kuadër të kategorisë Shpenzime kapitale dhe në kuadër të fondit të njëjtë, Fondi 21.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Formulari i Thesarit

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente kommunale.

5. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

#### **10. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit përkrahje financiare;**

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se Vushtrria është me fat që kemi një kuadër siç është Pranvera Hyseni, dhe shtoj se si grup e përkrahin kërkesën e saj për mbështetje financiare, dhe ceku se nëse ka mundësi që të rritet kjo shumë atëherë ata do ta përkrahin.**

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit –tha se grup e përkrahin kërkesën e znj. Pranvera Hyseni, dhe shtoj se është mirë që ka filluar edhe tek ne të vlerësohet fizika dhe astronomia për shkak se është ndër profesionet më deficitare në Kosovë.**

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-propozoi që shuma e mjeteve të rritet në 3000 € për mbështet financiare për Pranvera Hysenin.**

**Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare për znj. Pranvera Hyseni në vlerë prej: tre mijë euro (3000 €), për financimin të evenimentit shkencor përkatësisht projekti “Festivali i Astronomisë-(Astrofest)” që planifikohet të mbahet në Vushtrri nga data: 09-16 gusht 2022.

2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi merren nga buxheti i komunës kategoria subvencione dhe transfere në zyrën e kryetarit të komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente kommunale.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

#### **11. Shqyrtim i planit për vlerësimin e rrezikut në territorin e Komunës së Vushtrrisë;**

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit –tha se ky dokument është i hartuar në mënyrë profesionale dhe njëjtë është i pasuruar me të dhëna dhe statistika mjaft të vlefshme për Komunën e Vushtrrisë, andaj e përgëzojmë drejtorinë për një punë të tillë.**

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se ky dokument është punuar në mënyrë mjaft të mirë dhe profesionale, i njëjtë ka nevojë për disa përmirësimë teknike. Sa i përket përbërjes gjinore në dokument thuhet se 49 % janë meshkuj ndërsa 51 % femra, kjo nuk dihet sa është qëndrueshme përfaktin se në një hulumtim të Institutit KIPRED në vitin 2019, ku thuhet se raporti gjinor në Komunën e Vushtrrisë është 51.5% meshkuj, ndërsa 48.5% femra. Në faqe 77 të dokumentit thuhet se disa fshatra të Komunës së Vushtrrisë janë të atakuara nga ndotjet e KEK-ut, e ndërsa në saje të Ligjit përf Obiliqin, ku qytetarët paguajnë më lirë energjinë elektrike, atëherë duhet ti gëzojnë këto të drejta edhe banorët e atyre fshatrave që atakohen e që gravitojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.**

**Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet Vlerësimi i Rrezikut përf Territorin e Komunës së Vushtrrisë.
2. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përf Mbrojtje dhe Shpëtim që të ndërmerr masa pëf implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të nivelit qendror dhe me organizmat tjera relevant.
3. Qëllimi i hartimit të këtij vlerësimi është të paraqesë të dhëna të përgjithshme përf Komunën e Vushtrrisë, të vlerësohen rreziqet që i kanosen popullatës dhe Komunës së Vushtrrisë në përgjithësi, si dhe të parashev mekanizmat që duhet ti përdor komuna me qëllim të mënjanimit të rrezikut që mund ti kanoset.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Vlerësimi i Rrezikut përf Territorin e Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria përf Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe drejtorit tjera kompetente komunale.
6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**12. Shqyrtimi i Propozim – vendimi përf ngritje të lartësisë së pagesës së mjeteve financiare përf shërbimet e kryera nga K.R.M. “Uniteti” SH.A në Mitrovicë ndaj Komunës së Vushtrrisë;**

**Sylejman Mehollı, anëtar i kuvendit** –tha se e mbështesin këtë propozim-vendim, përf fakti se kompania vërtet ka nevojë përf mbështetje financiare, por edhe përkund krizës që ka pasur kompania ajo është duke e kryer punën me mjaft sukses.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se e mbështesin këtë propozim-vendim në tërësi dhe propozoi që këtij vendimi ti shtohet edhe një pikë shtesë, që pjesë prej 40 centë ti shtohet edhe vlera prej 30 centë të cilat drejtpërdrejt do ti dedikohen ngritjes së pagës përf stafin teknik të operativës së Kompanisë “Uniteti”.

**Islam Latifi, zyrtar në DSHP**-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke njoftuar se ngritje të lartësisë së pagesës së mjeteve financiare përf shërbimet e kryera nga K.R.M. “Uniteti” SH.A në Mitrovicë ndaj Komunës së Vushtrrisë, është bërë si rezultat i kritës së madhe që po mbretëron dhe rritjes së kostos përf ofrimin e shërbime përf grumbullimin e mbeturinave.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se Kompania “Uniteti” e ka të pamundur që me koston aktuale të ofroj shërbime për shkak të rritjes së çmimeve, andaj si rezultat i kësaj krize jemi të obliguar ta ngritim këtë taksë. Ndërsa para nënshkrimit të kontratës me kompaninë “Uniteti” për vitin 2023 do shtrohen të gjitha temat e funksionimit dhe çështja e taksës dhe inksimi për vitin fiskal 2023.**

**Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet ngritura e lartësisë së pagesës së mjeteve financiare nga buxheti i komunës – kategoria mallra dhe shërbime, në llogari të K.R.M. “Uniteti” SH.A në Mitrovicë për shërbimet e kryera për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë - mbledhja dhe transporti i mbeturinave për ekonomi familjare, nga 3.00 € në 3.40 €.
2. Obligohet Kryetari i Komunës që të negocioj marrëveshje mirëkuptimi me përfaqësuesin ligjorë të K.R.M. “Uniteti” SH.A në Mitrovicë për lartësinë e pagesës së përcaktuar si në pikën 1 (një) të këtij vendimi si dhe për ofrimin e shërbimeve të larje fshirjeve të rrugëve në qytet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe do të zbatohet nga data 01.09.2022.

**13. Informatë për gjendje e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë;**

**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-paraqiti sqarime lidhur me gjendjen e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë, duke njoftuar se raportin për gjendjen epidemiologjike e kanë pranuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ku në këtë raport janë përshkruar indikatorët bazë të gjendje së jetës: sëmundjet infektive, siguria ushqimore, dhe uji i pijshëm.**

**Sylejman Meholfi, anëtar i kuvendit** –tha se është fat se këto kohëve të fundit Komuna e Vushtrrisë nuk ka pasur ndonjë intoksikacion alimentar nuk ka pasur helmime, ka ngecur raportimi lidhur me sëmundjet ngjitime të ana e profesionistëve shëndetësor, kështu që drejtoria duhet të njoftoj për rastet e sëmundjeve ngjitime. Më pas tërheq vëmendjen se mund të ketë rrezikim të vaksinave për shkak të reduktive të energjisë elektrike ku dëmtohet sistemi i ftoshjes deh kësijo mund të vjen deri tek ndonjë komplikim gjatë procesit të imunizimit. Andaj kërkoj nga kryetari i komunës që të apeloj tek KEDS-i që këto reduktimet të zvogëlohen sa të jetë e mundur me qëllim të evitimit të rrezikut sa i përket rrjeti të ruajtjes dhe ftoshjes së vaksinave.


**14. Shqyrtimi i kërkesës të Bashkësisë Lokale të fshatit Stanoc për rregullimin e varrezave për dëshmorët Sadri Mala dhe Sadik Mala;**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në vlerë prej tre mijë euro (3000 €), për realizimin e projektit <ndërtimi i lapidarit për dëshmorët Sadik Mala dhe Sadri Maksuti> në fshati Stanoc i Epërm.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendim do të merren nga buxheti i komunës kategoria investime kapitale, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve për realizimin me bashkëfinancim të këtij projekti do të sigurohen nga participimi i qytetarëve i atij lokaliteti.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Shërbime Publike si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:55.**

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit

